




**REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**  
**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI-CORRUPTION AGENCY**

Dep.	2-D/DPK	Nr. Prot.
Dep.		B-Prot.
Dep.		Prot No.
Nr. I faq.	03	01-3431/14
Broj stranica		Date
Nr. pages		Datum
		02.10.2014

PRISHTINE



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

<b>DATË/A:</b>	01.10.2014
<b>REFERENC-Ë:</b>	AKK-DPK
<b>PËR/ZA/TO:</b>	z. Besnik Hajdari, u.d. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Infrastrukturës
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Hasan Preteni, Drejtore i Agjencisë kundër Korruptionit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik

I nderuar z. Hajdari

Lidhur me kërkesën tuaj drejtuar Agjencisë kundër Korruptionit (DPK-03-1863/14), ju njoftojmë se në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korruptionit lidhur me çështjen e konfliktit e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtejshmë Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), Agjencia kundër Korruptionit, ndër të tjera, bën këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eproreve, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave (neni 19, pika 1.5).

Prandaj, duke u përgjigjur kërkesës tuaj dhe pas takimit qe kemi pasur me ju në zyrat e Ministrisë se Infrastrukturës, dhe pas ofrimit te fakteve lidhur me kërkesën tuaj drejtuar AKK-së, për sqarimin e situatës qe ndërlidhet me Departamentin e Automjeteve gjegjësisht me zyrtarët ne Divizionin e Patentë Shoferëve, dhe punësimi apo përfshirja e disa anëtarëve te familjes në cilësi te shofereve Instruktor ne disa auto shkolla private.



Agjencia kundër Korruptionit si institucion kompetent lidhur me parandalimin e konfliktit të interesit ne ushtrim te funksionit publik, në bazë te fakteve te ofruara dhe informatave qe ka nxjerr këtë:

## OPINION

**Angazhimi i anëtareve te familjes te disa zyrtarëve (shërbyesve civil) nga Divisionin i Patentë Shoferëve ne Departamentin e Automjeteve te Ministrisë se Infrastrukturës, ne cilësi te shofereve, instruktoreve ne auto shkolla private nuk paraqet konflikt te interesit dhe nuk është e ndaluar me ligjin ne fuqi, mirëpo është obligim i çdo zyrtari dhe çdo shërbyesi civil qe te shmang çfarë do situate të mundshme të konfliktit te interesit.**

### Arsyetim

Agjencia kundër Korruptionit është institucion i pavarur të cilit me ligj i janë besuar përgjegjësi të veçanta. Sipas nenit 5 (parografi 1, nën parografi 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia është autoritet qendror i cili ndër të tjera bën edhe mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve qe kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara me ligj.

Rrjedhimisht, çështja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik është e rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtejshmë Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit). Në bazë të këtij ligji zyrtaret e dyshuar nga ana juaj, se mund te jenë në gjendje te konfliktit te interesit nuk hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik, pasi qe shprehimisht nuk janë te përcaktuar ne nenin 4 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në bazë të nenit 7.6 të këtij ligji thuhet se : Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk ka të drejtë të krijojë marrëdhënie varësie nga persona tjerë që do të mund të ndikonin në paanshmërinë dhe shprehjen e vullnetit të lirë në vendimmarrje.

Po ashtu edhe në pikën 8 të këtij nenii zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm, ndërsa sipas nenit 8 të këtij ligji, te gjithë zyrtaret e lartë kane detyrë qe te parandalojnë e konfliktit të interesit dhe të zgjidhin vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tyre të interesit.

Agjencia kundër Korruptionit, vlerëson se zyrtaret qe ju keni aluduar se mundë te kenë konflikt te interesit kanë statusin e shërbyesit civile dhe nuk janë cilësuar si zyrtar të lartë sipas LPKI, ndërsa për ta është obligim qe gjithmonë kur munde te paraqitet një situatë e konfliktit te interesit duhet te veprojnë sipas nenit 5 pika 1.8 te ligjit (LIGJI Nr. 03/L-149 PËR SHËRBIMIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS ) ku thotë se (Nëpunësit civilë duhet të mos lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin kryerjen e detyrave



private ose publike, që bien ndesh me pozitën e tyre dhe që mund të krijojnë konflikt interesit. Nëpunësit civilë veprojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe ligjit në fuqi për shmangjen e konfliktit të interesit).

Bazuar ne faktet dhe gjendjen e tanishme lidhur me çështjen e ngritur nga ana e juaj si dhe ne bazë asaj që u tha më lartë, iu rekomandojmë që të ndërmerrni të gjitha masat konform ligjeve ne fuqi si dhe ne bazë te kompetencave tuaja si institucion qe te hartoni një dokument te brendshëm qe do ta rregullojë ne mënyre të qarte dhe precize çështjen e ngritur për arsy qe te mos ketë dilema dhe qe zyrtarët te kenë te precizuar se qfar ju ndalohet gjatë punës se tyre specifike. Andaj duhet të veproni konform këtij opinioni ,si dhe te na njoftoni nëse paraqiten fakte dhe rrethana tjera, njehërit ju si institucion duhet te që të parandaloni çdo situatë qe mund te shkaktoj konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Me respekt!

